



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ZYRA E PROKURORIT TE PËRGJITHSHËM

UDHËZIM
Nr. 1. Date 14.11.08

"Për ushtrimin me eficence te se drejtës se ankimit"

Me synimin :

- Për te garantuar bazushmërinë ne ligj te ushtrimit te se drejtës se ankimit nga prokuroret.
- Për te njehsuar praktikat ligjore te prokuroreve ne ushtrimin e ankimeve, pa prekur pavarësinë e tyre ne gjykim.
- Për te lehtësuar vlerësimin nga ana e prokuroreve me te larte te bazueshmërisë ligjore te qëndrimeve te prokuroreve me 'te ulet ne fazën e gjykimit.

Mbështetur ne :

- nenin 24.4 te Kodit te Procedurës Penale,
- nenin 8.2 te Ligjit nr. 8737 date 12.02.2001 « Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë ne Republikën e Shqipërisë »

UDHËZOJ

1. USHTRIMII SE DREJTËS SE APELIT

1.1 Prokurori i seancës, ne gjykimin e ceshtjes ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet te ushtroje apel kur Gjykata ka vendosur ne kundërshtim me konkluzionet e tij përfundimtare apo me kërkesën e tij lidhur me :

- a. Alternativat e ekzekutimit te dënimit, te parashikuara ne Kodin Penal,
- b. Kërkesat qe lidhen me ekzekutimin e dënimeve, te parashikuara ne Titullin IX, Kreun II, te Kodit te Procedurës Penale.

- c. Masën e dënimit, duke deklaruar:
 - i. mosvendosjen e saj për mungese të përgjegjësive penale për çdo shkak.
 - ii. caktimin e një mase dënimi në minimumin e parashikuar nga ligji penal.
 - iii. caktimin e një mase dënimi me pak se gjysma e dënimit të kërkuar nga prokurori i seancës në konkluzionet e tij përfundimtare, kur masa e dënimit e kërkuar ka qene mbi 4 vjet burg.
 - iv. caktimin e një mase dënimi me një diferencë me shumë se 4 vjet burgim nga kërkesa e prokurorit në konkluzionet përfundimtare.
- d. Masën e sigurimit arrest në burg të kërkuar për një veprë penale të kryer me dashje dhe që parashikon dënim me minimum jo më pak se 3 vjet burgim, duke deklaruar heqjen e saj.
- e. Masën e sekuestros apo konfiskimit të caktuar sipas Kodit të Procedurës Penale apo sipas Ligjit Nr. 9284, datë 30.9.2004 « Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar », duke deklaruar heqjen e saj.

1.2 Prokurori i seancës në gjykimin e ceshtjes në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet të ushtroje ankim kur Gjykata ka vendosur në kundërshtim me konkluzionet e tij përfundimtare, qoftë edhe pjesërisht, si dhe kur akuza bën fjale për :

- a. veprime apo mosveprime korruptimi
- b. veprime apo mosveprime pastrimi parash
- c. veprime apo mosveprime në shpërdorim të detyrës ose që lidhen me detyrën, të kryera nga autore në rolin e
 - drejtuesit të një organi apo një strukture organike shtetërore, pavarësisht nga niveli i kësaj strukture në hierarkinë organike
 - prokurorit, gjyqtarit, oficerit të policisë gjyqësore,
 - punonjësit të strukturës policore, të zyrave doganiere apo të tatimeve,
- d. veprime apo mosveprime të autoreve recidiviste.

1.3 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet të ushtroje apel kur konstaton se prokurori i seancës nuk ka ushtruar ose refuzon të ushtroje apel për rastet e parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi.

1.4 Paragrafët e mësipërm nuk e ndalojnë prokurorin të bejë apel jashtë rasteve të parashikuara në to.

2. AUTORIZIMI PËR TE MARRE PJESE NE GJYKIMIN NE APEL

- 2.1 Kur prokurori i seancës ne gjykimin ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, vlerëson te marre pjese vete ne Gjykatën e Apelit, ai duhet te shprehet për këtë ne aktin e apelit. Ne këtë rast Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor duhet t'i paraqesë sa me pare kopjen e aktit te apelit Drejtuesit te Prokurorisë se Apelit
- 2.2 Kur prokurori i seancës ka shprehur vullnetin e tij ne aktin e apelit, sipas paragrafit 2.1 te këtij Udhëzimi, Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit, kur refuzon te mbështesë këtë apel, detyrohet te autorizojë me shkrim prokurorin e seancës ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor për te marre pjese ne gjykimin ne Gjykatën e Apelit.

3. USHTRIMI I SE DREJTËS SE APELIT KUNDËRSHTUES

- 3.1 Prokurori i seancës ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet te ushtroje apel kundërshtues kur Gjykata ka vendosur ne kundërshtim me konkluzionet e tij përfundimtare, qofte edhe pjesërisht.
- 3.2 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, si rregull, duhet te ushtroje apel kundërshtues kur prokurori i seancës refuzon, edhe pse ndodhet para rastit te parashikuar nga paragrafi 3.1.

4 USHTRIMII SE DREJTËS SE APELIT NGA PROKURORI PRANË GJYKATËS SE APELIT

- 4.1 Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit duhet te marre masa për te ushtruar apel për rastet e parashikuara ne piken 1.1 dhe 1.3 kur ai vihet ne dijeni paraprakisht, kryesisht apo përmes ankesave te palëve ne proces, se ka shkaqe për te besuar se prokurori I seancës ose Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor, mund te refuzojnë te ushtrojnë apel.

5. USHTRIMI I SE DREJTËS SE REKURSIT KUR ËSHTË USHTRUAR APEL NGA PROKURORIA

- 5.1 Prokurori pranë Gjykatës se Apelit, si rregull, duhet të ushtroje rekurs në rastet e parashikuara në paragrafin 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi, kur ceshtja është shqyrtuar në Gjykatën e Apelit mbi apelin ose apelin kundërshtues të prokurorit.
- 5.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit, si rregull, duhet të ushtroje rekurs kur konstaton se, edhe pse ndodhet para një prej rasteve të parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi, prokurori në Prokurorinë e Apelit refuzon ushtrimin e rekursit.
- 5.3 Prokurori në Drejtorinë Gjyqësore, si rregull, duhet të ushtroje rekurs kur konstaton se, edhe pse ndodhet para një prej rasteve të parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi, Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit refuzon ushtrimin e rekursit.
- 5.4 Paragrafët e mësipërm nuk e ndalojnë prokurorin të beje rekurs jashtë rasteve të parashikuara në to.

6. USHTRIMI I SE DREJTËS SE REKURSIT KUR NUK ËSHTË USHTRUAR APEL NGA PROKURORIA

- 6.1 Prokurori në Prokurorinë e Apelit, si rregull, duhet të ushtroje rekurs për ceshtjet e gjykuara vetëm mbi apelin e të pandehurit kur vendimi i Gjykatës së Apelit:
 - a. Ka ulur masën e dënimit me burgim, sa gjysma ose me shume se sa masa e dënimit të kërkuar nga prokurori i seancës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.
 - b. Ka ulur masën e dënimit me burgim me 4 vjet ose me shume se sa masa e dënimit të kërkuar nga prokurori i seancës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor
 - c. Ka dhënë pafajësi qofte edhe për një nga akuzat e ngritura apo qe lidhen vetëm me një prej të pandehurve.
 - d. Ka shfuqizuar masën e sigurimit të kërkuar nga Prokuroria qofte edhe kur ajo është zëvendësuar me një mase sigurimi tjetër.
 - e. Ka shfuqizuar masën e sekuestros ose të konfiskimit të vendosur sipas Ligjit Nr. 9284, datë 30.9.2004 «Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar»
- 6.2 Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit, si rregull, duhet të ushtroje rekurs kur, edhe pas analizës, prokurori në Prokurorinë e Apelit refuzon të ushtroje rekurs në rastet e parashikuara nga paragrafi 6.1 i këtij Udhëzimi.

- 6.3 Prokurori ne Drejtorinë Gjyqësore, si rregull, duhet te ushtroje rekurs kur konstaton se ushtrimi i rekursit refuzohet nga Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit, për rastet e parashikuara nga paragrafi 6.1 i këtij Udhëzimi.
- 6.4 Paragrafët e mësipërm nuk e ndalojnë prokurorin te beje rekurs jashtë rasteve te parashikuara ne to.

7. PROCEDURA E HEQJES DORE NGA ANKIMI

- 7.1 Prokurori mund te heqë dore nga ankimi vetëm pasi ka njoftuar paraprakisht me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë përkatëse për shkaqet e heqjes dore si dhe pasi ka zhvilluar analizën e këtij rasti me Drejtuesin e Prokurorisë.
- 7.2 Kur ankimi është ushtruar nga Drejtuesi i Prokurorisë njoftimi për heqjen dore nga ankimi si dhe analiza përkatëse e rastit do te behet me Drejtuesin e Prokurorisë se një shkalle me lart.
- 7.3 Për rastet e parashikuara nga paragrafi 1.3 i këtij Udhëzimi prokurori mund te heqë dore nga ankimi vetëm pasi ka njoftuar me shkrim Drejtorinë Gjyqësore dhe pasi ka zhvilluar analizën e këtij rasti pranë kësaj Drejtorie.
- 7.4 Prokurori i Drejtorisë Gjyqësore mund te heqë dore nga rekursi pasi ka njoftuar paraprakisht me shkrim Drejtorin e Drejtorisë Gjyqësore dhe pasi është kryer analiza e këtij rasti ne mbledhjen e Drejtorisë.

8. INFORMIMI I DREJTUESIT TE PROKURORISË PRANË GJYKATËS SE RRETHIT GJYQËSOR

- 8.1 Prokurori i seancës duhet te informoje me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë ne Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, duke parashtruar arsyet e qëndrimit te tij, kur :
- a. Refuzon te ushtroje apel ose apel kundërshtues për rastet e parashikuara ne paragrafin 1.1 dhe 1.3 te këtij Udhëzimi.
 - b. Gjykon se duhet te heqë dore nga apeli ose apeli kundërshtues.

9. INFORMIMI I DREJTUESIT TE PROKURORISË SE APELIT

9.1 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor duhet të informojë me shkrim Drejtuesin e Prokurorisë së Apelit, duke parashtruar arsyet përkatëse, për rastet kur :

- a. Pranon refuzimin e prokurorit të seancës për të mos bërë apel apo apel kundërshtues për rastet e parashikuara në paragrafin 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi.
- b. Pranon heqjen dore të prokurorit të seancës nga apeli apo apeli kundërshtues, duke parashtruar edhe qëndrimin e tij ndaj heqjes dore të prokurorit të seancës.
- c. Pranon si të bazuar qëndrimin e prokurorit të seancës për të kërkuar në konkluzionet përfundimtare pafajësi, pushim të ceshtjes penale për mungesë provash, apo një cilësim ligjor të veprës penale të ndryshëm nga kërkesa për gjykim.

10. INFORMIMI I DREJTORISË GJYQËSORE

10.1 Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit duhet të informojë me shkrim Drejtorinë Gjyqësore, duke parashtruar arsyet përkatëse, kur :

- a. Pranon refuzimin e prokurorit në Gjykatën e Apelit për ushtrimin e rekursit për rastet e parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi.
- b. Pranon refuzimin e prokurorit në Gjykatën e Apelit për përkrahje të apelit apo apelit kundërshtues të prokurorit në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, për rastet e parashikuara nga paragrafët 1.1 dhe 1.3 të këtij Udhëzimi.
- c. Pranon si të bazuar qëndrimin e prokurorit në Gjykatën e Apelit për të kërkuar në konkluzionet përfundimtare pafajësi apo një dënim me të lehte nga ai i kërkuar nga prokurori në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.
- d. Rezulton e pamundur të kërkohet një dënim me i rende në Gjykatën e Apelit, për shkak të mos ushtrimit të apelit apo apelit kundërshtues nga prokurori në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.
- e. Konstaton qëndrime të gabuara në ushtrimin e së drejtës së ankimit nga prokuroret me të ulet.

10.2 Prokurori i seancës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor, i cili ka marrë pjesë në gjykimin në Gjykatën e Apelit me autorizim të prokurorit në Gjykatën e Apelit, duhet të informojë me shkrim Drejtorinë Gjyqësore mbi mënyrën e përfundimit të ceshtjes, menjëherë pas përfundimit të saj.

11. INFORMIMI I DREJTORISË SE INSPEKTIMIT DHE BURIMEVE NJERËZORE

- 11.1 Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës se Rrethit Gjyqësor duhet të informoje me shkrim Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore kur:
- a. Apeli apo apeli kundërshtues, i ushtruar prej tij në kushtet e refuzimit nga prokurori i seancës, pranohet nga Gjykata e Apelit, qofte edhe pjesërisht.
 - b. Konstaton qëndrime të gabuara të prokuroreve lidhur me ushtrimin e apelit apo apelit kundërshtues, heqjen dore prej tij ose shkelje të këtij Udhëzimi.
- 11.2 Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit duhet të informoje me shkrim Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore kur;
- a. Rekursi i ushtruar prej tij, në kushtet e refuzimit të ushtrimit të rekursit nga prokurori në Prokurorinë e Apelit, pranohet nga Dhoma e Këshillimit të Gjykatës se Larte.
 - b. Konstaton qëndrime të gabuara të prokuroreve lidhur me ushtrimin e apelit apo apelit kundërshtues, heqjen dore prej tij ose shkelje të këtij Udhëzimi.
- 11.3 Drejtoria Gjyqësore duhet të informoje me shkrim Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore kur :
- a. Rekursi i ushtruar prej prokurorit në Drejtorinë Gjyqësore, në kushtet e refuzimit të ushtrimit të rekursit nga Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit, pranohet nga Dhoma e Këshillimit të Gjykatës se Larte.
 - b. Konstaton qëndrime të gabuara të prokuroreve lidhur me ushtrimin e rekursit, përkrahjen ose heqjen dore prej apelit apo apelit kundërshtues ose shkelje të këtij Udhëzimi.

12. INFORMIMI I PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM

- 12.1 Drejtori i Drejtorisë Gjyqësore informon sa më parë me shkrim Prokurorin e Përgjithshëm kur :
- a. Rekursi i ushtruar nga prokuroret e Drejtorisë Gjyqësore, në kushtet e refuzimit për të ushtruar rekurs nga Drejtuesi i Prokurorisë se Apelit, pranohet për shqyrtim nga Dhoma e Këshillimit të Gjykatës se Larte.
 - b. Prokurori i Drejtorisë Gjyqësore kërkon të heq dore nga rekursi, duke parashtruar edhe qëndrimin e mbledhjes së Drejtorisë

12.2 Kur prokuroret e ngarkuar me detyrimin për të informuar shkeljet e këtij Udhëzimi apo qëndrimet e gabuara të prokuroreve në ushtrimin e ankimit, nuk informojnë Drejtorinë e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore, do të konsiderohet se ata nuk e kanë konsideruar si shkelje qëndrimin e prokurorit për rastin e pajformuar.

13 DOKUMENTACIONI SHOQËRUES

13.1 Për rastet e detyrimit për informim të parashikuara në këtë Udhëzim, bashkëlidhur informacionit me shkrim, duhet të paraqitet sipas rastit edhe:

- a. Kopje e vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor.
- b. kopje e konkluzioneve të prokurorit të seancës në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor.
- c. kopje e konkluzioneve të tij në gjykimin në Gjykatën e Apelit
- d. kopje e vendimit të Gjykatës së Apelit
- e. çdo akt tjetër që vlerëson se lehtëson analizën e qëndrimit të tij ose që kërkohet nga prokurori i ngarkuar sipas këtij Udhëzimi me analizën e qëndrimit të tij.

14 Për shkelje të konstatuara në zbatimin e këtij Udhëzimi Drejtoria e Inspektimit dhe Burimeve Njerëzore informon Prokurorin e Përgjithshëm dhe sipas rëndësisë së shkeljes propozon nisjen e procedimit disiplinor.

15 Udhëzimi nr. 3 datë 09.12.2003 "Për ushtrimin e të drejtës së ankimit nga prokurori" shfuqizohet

16 Ky Udhëzim hyn në fuqi në datën Dt. 01. 12. 2008

PROKURORE E PËRGJITHSHME

INA RAMA